

VENDIM

Nr. 19, Datë 22.01.2014

PËR CAKTIMIN E VEPRIMEVE PËR PËRMBYLLJEN E PROCESIT TË LËSHIMIT TË KARTONIT TË DIPLOMAVE TË PADORËZUARA STUDENTËVE

Senati i Universitetit të Arteve, në mbledhjen e tij të datës 22.01.2014, pasi materialet e paraqitura, bazuar në nenin 39 të Ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në RSH", i ndryshuar,

VËREN

Nga dokumentacioni i evidentuar nga Sekretaritetë Mësimore të Fakulteteve, ka rezultuar se janë gjendje një numër diplomash të plotësuara për studentë të shkollës sonë, të cilët kanë dhënë provimin e diplomës (data më e fundit është data 28.02.2012), por për arsye të mos paraqitjes nga ana e studentëve të fotografisë së tyre, kanë mbetur pa u plotësuar me nënshkrime dhe/ose pa u vulosur me vulën e institucionit.

Duke pasur në konsideratë se këto diploma janë plotësuar në referim të viteve akademike të mëparshme, në të cilat shkolla jonë ka pasur emërtimin Instituti i Lartë i Arteve dhe Akademia e Arteve, është e domosdoshme që të rregullohet përputhshmëria e elementëve që bëjnë të vlefshme diplomën si një dokument provues për përfundimin e studimeve nga studentët përkatës.

Në referim të listës përkatëse të studentëve, të cilët nuk kanë tërhequr diplomën për shkak të mungesës së fotografisë së studentit, me marrjen e një vendimi nga ana e Senatit Akademik të Universitetit të Arteve, rregullohet dhe përfundohet ky proces duke vënë në dijeni njëkohësisht edhe Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Për sa më sipër, Senati Akademik i Universitetit të Arteve,

VENDOSI

1. Diplomat plotësuara dhe të padorëzuara studentëve sipas Lidhjes 1, bashkëlidhur këtij Vendimi, të cilët kanë dhënë provimin e diplomës deri në datën 28.02.2012, përfshirë

këtë datë, të pajisen me fotografinë e studentit dhe të vulosen me vulën në përdorim të Universitetit të Arteve;

2. Ky vendim i bëhet me dije Ministrisë së Arsimit dhe Sportit
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Lidhja 1

Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Fakulteti	Programi i studimit	Viti i fillimit të studimeve	Viti i mbarimit të studimeve	Data e diplomimit	Nr. Diplomes	Data e lëshimit të diplomës	Nr. regjistrit
1.	BESA	BASHKIM	MEMAJ	FM	KANTO	2006	2012	08.02.2012	5706	17.05.2013	2805
2.	JETMIR	ENVER	TULA	FM	KOMPOZICION	2000	2012	28.02.2012	5703	17.05.2013	2089
3.	ANDI	FERDINAND	TRUNGU	FM	MUZIKOLOGJI	2005	2012	28.02.2012	5704	17.05.2013	2629
4.	INA	ILIR	MILLOSHI	FM	PIANO	2005	2012	07.02.2012	5705	17.05.2013	2649
5.	ELDA	RESHAT	ZEQAJ	FAS	KOREOGRAFI	1998	2002	08.07.2002	3935	08.07.2002	93
6.	RUDINA	AGIM	BUXHELI	FAS	REGJI	2002	2007	10.07.2007	4659	10.07.2007	141
7.	EVIS	MUHARREM	HETA	FAS	KOREOGRAFI	2002	2008	26.02.2008	4504	26.02.2008	132
8.	BESNIK	GËZIM	DABULLA	FAB	GRAFIKË	2002	2007	09.07.2007	4799	12.07.2007	1387